



Belinoz post' Pw
Aurela Saliaj

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK**

Nr. 751/14 Prot.

Vlorë, më 24.2.2025

VENDIM

Nr. 17, datë 24.02.2025

PËR

**ANËTARËSIMIN E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI" NË
INFRASTRUKTURËN 'CROSSREF'**

Rritja e vizibilitetit dhe e autenticitetit të botimeve të Universitetit "Ismail Qemali" kërkon bashkëpunimin me infrastruktura ndërkombëtare, siç është "Crossref", për botime si "Buletini shkencor" dhe artikujt e botuar në të. Ky bashkëpunim ka si qëllim marrjen e numrit DOI (Digital Object Identifier) për botimet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë, si një numër unik, i pandryshueshëm, që bën më të lehtë kërkimin dhe aksesin në dokumentat digjitale si gazeta, revista, artikuj online, etj. Me anë të DOI mund të krijohen dhe të ruhen regjistrime të pasura meta të dhënash, duke shtuar informacione të lidhjeve, origjinës, kontribuesve dhe financimit dhe duke përfutur kështu, nga lidhjet reciproke midis një rrjeti global objektsh kërkimore.

Në mbështetje të nenit 93/4, 94/2 të Ligjit nr. 80/ 2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", me qëllim rritjen e autenticitetit dhe aksesit në punimet shkencore të UV dhe pedagogëve të tij, Senati Akademik në mbledhjen e datës 24.02.2025,

VENDOSI

1. Universiteti 'Ismail Qemali' Vlorë të fillojë procedurat për anëtarësimin në infrastrukturën e hapur ndërkombëtare "Crossref" dhe marrjen e numrit DOI (Digital Object Identifier) për botimet e Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë (Buletin Shkencor dhe artikuj), nëpërmjet Sektorit të Bibliotekës dhe Botimeve.
2. Një kopje e këtij vendimi i bëhet me dije Administratorit, Zëvendësrektorit Akademik dhe Zëvendësrektorit për Marrdhëniet me Jashtë dhe Kërkimin Shkencor.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARE E SENATIT AKADEMIK

Prof.Dr. AURELA SALIAJ

AS Saliaj

